



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Dokument i Komisionit

VENDIM

Nr.15, datë 30.07.2015

"Për miratimin në parim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri"

Bazuar në nenet 24 dhe 32-41 të Regullores së Kuvendit, në pikën II, paragrafi i dytë i Vendimit Nr. 96/2014, datë 27.11.2014 të Kuvendit të Shqipërisë "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë" të ndryshuar, me propozim të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Komisioni :

VENDOSI :

I. Të miratojë në parim dokumentin Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Të miratojë në parim dokumentin, Plani i Veprimit për zhvillimin e strategjisë për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Dokumentet e mësipërme të shërbejnë si dokumente orientuese për zhvillimin e fazës së III-të të procesit për reformën në sistemin e drejtësisë. Ato mbeten të hapura për komente e propozime për përmirësimin e tyre. Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë të vazhdojë të organizojë procesin e konsultimit publik dhe konsultimin me ekspertizën ndërkombëtare si dhe të vlerësojë e reflektojë përfshirjen e tyre në këto dokumente.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Fatmir XHAFAJ